



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

Nr. 9142/12 Prot.

Tiranë, më 06. 12. 2014



MIRATOHET

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

UDHËZUESI PËR

KARTËN E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS

A. HYRJJE

I. Dobia e Kartës së Performancës së Shkollës

Karta e Performancës së shkollës, më tutje "Karta", jep të dhëna për ecurinë e shkollës gjatë një viti shkollor. Karta bën të qartë për prindërit pikët e forta dhe të dobëta të shkollës ku fëmija e tyre mëson ose do të mësojë. Në sajë të Kartës, prindërit e kanë më të mundur të kërkojnë përmirësime të caktuara në arritjet e shkollës dhe të japin ndihmesën e tyre për këto përmirësime.

Të dhënat e Kartës janë të vlefshme për drejtuesit dhe mësuesit e shkollës që të pikasin aspektet që kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe për t'i përfshirë në planin e tyre afatmesëm dhe atë vjetor.

Njësitë arsimore vendore do të kenë tani e tutje një "hartë" të hollësishme të arritjeve dhe mosarritjeve të shkollave në juridiksion, prandaj do ta kenë më të lehtë të gjejnë shkollat që kanë arritje të larta për tregues të veçantë ose në përgjithësi dhe pastaj të përhapin përvojat e tyre të suksesshme, po ashtu, shkollat që janë prapa për tregues të veçantë ose në përgjithësi dhe pastaj t'i ndihmojnë ato për t'u përmirësuar.

Kartat i vlejné, gjithashtu, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit për të planifikuar inspektimet tematike, të orientuara, të plota dhe për të identifikuar përvoja të suksesshme.

Karta bëhet publike për prindërit, nxënësit, personelin e shkollës dhe komunitetin e saj, si dhe për njësinë arsimore vendore.

II. Grupimi i shkollave për renditjen e tyre

Karta përfshin shkollat publike dhe ato private.

Shkollat renditen veç për arsimin bazë dhe veç për gjimnazet.

Renditja bëhet në nivel njësie arsimore vendore.

Kur një Zyrë Arsimore ka vetëm një ose dy gjimnaze, ato nuk renditen në nivel Zyre Arsimore, por bashkohen të gjitha gjimnazet e Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe renditen në nivel Drejtorie Arsimore Rajonale.

Një njësi arsimore vendore, sidomos kur numri i shkollave të arsimit bazë është i madh, mund të vendosë një ndarje të tyre, në dy grupe a pak më shumë.

Titullari i njësisë arsimore vendore vendos kriteret për grupimin e shkollave.

III. Treguesit e Kartës

Shkolla plotëson në fund të vitit shkollor *të gjithë treguesit* e përcaktuar në Udhëzues (përveç pyetësorëve) dhe i dërgon zyrtarisht të dhënat në njësinë arsimore vendore.

Lista e treguesve për renditje që do të përmbajë Karta në atë vit shkollor, përcaktohet çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Kjo pjesë e treguesve është e përbashkët për të gjitha shkollat e vendit dhe përbën treguesit qendrorë. Në treguesit qendrorë përfshihen edhe pyetësorët për nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Treguesit e tjerë përzgjidhen nga secila njësi arsimore vendore në listën e treguesve të Kartës ose mund të hartohen tregues të rinj që lidhen me ndjeshmërinë, politikat rajonale si rrjedhojë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit (SKA).

Në Udhëzimin e fillimit të vitit shkollor, MAS-i shpall, sipas përparësive të saj, treguesit qendrorë dhe numrin e treguesve që do të përzgjedhin njësitë arsimore vendore, përfshirë dhe pyetje nga pyetësorët.

Menjëherë pas daljes së Udhëzimit të fillimit të vitit shkollor, çdo njësi arsimore vendore shpall, sipas përparësive të saj, treguesit që ka përzgjedhur.

Lista e treguesve mund të ndryshohet nga viti në vit sipas përparësive të MAS-it. P.sh. nëse, për një periudhë, shpallet si përparësi forcimi i rolit të bordit të shkollës, shtohen ose detajohen tregues për veprimtarinë e bordit.

Llojet e treguesve janë:

- a) Tregues, të dhënat e të cilëve llogariten nga shkollat. P.sh "Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të viti shkollor".
- b) Tregues të pyetësorëve me nxënës, prindër të tyre dhe mësues.
- c) Tregues që matin ndryshimin në mes një shkolle të caktuar dhe nivelit kombëtar. P.sh për treguesin "Nota mesatare e shkollës në provimet e Maturës shtetërore" krahasohet kjo notë mesatare e shkollës me mesataren në nivel kombëtar.

Përveç vitit të parë të përdorimit të saj, në vitet pasuese, Karta përmban për tregues të caktuar edhe ndryshimin e tij ndërmjet dy viteve të njëpasnjëshme shkollore.

B. TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË KARTËS

1. Shkolla "..."(emri i shkollës i cili shoqërohet edhe me foto të saj);
2. Adresa elektronike e shkollës: (Jo adresë personale e drejtorit apo e dikujt tjetër, por e shkollës, nëse ka. P.sh. bajramcurri9vj@yahoo.com;
3. Numri i nxënësve të shkollës të regjistruar në fillim të vitit të kaluar shkollor;
4. Objektivi (objektivat) e planit vjetor aktual të shkollës.
Për këtë tregues shihni Dispozitat Normative, Kreu XII, neni 67;
5. Përqindja e kalueshmërisë së shkollës në fund të vitit të kaluar shkollor;
6. Nota mesatare e shkollës në fund të vitit të kaluar shkollor.
7. Vlerësimi i shkollës nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit gjatë atij viti (nëse është kryer një inspektim i plotë.)
8. Të tjera
Drejtoria e shkollës, pas marrjes së mendimit nga këshilli i mësuesve, mund të vendosë për të dhëna të tjera të shkollës si:
 - Të ardhurat financiare të siguruar prej saj,
 - lëndë të veçanta me zgjedhje që ofron,
 - karakteristika sociale e demografike të shkollës,
 - përqindja e nxënësve romë, me aftësi të kufizuara,
 - përqindja e mësuesve me titullin "Mësues mjeshtër", që kanë mbaruar studimet në doktoraturë,
 - laboratorë funksionalë.

C. TREGUESIT PËR RENDITJEN E SHKOLLAVE TË ARSIMIT BAZË/GJIMNAZIT

1. Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor

Drejtoria e shkollës, bazuar në të dhënat e mësuesve kujdestarë, plotëson tabelën e mëposhtme për të gjitha klasat e shkollës. Nuk përfshihen në llogaritjet nxënësit e ardhur në shkollë gjatë vitit mësimor.

Numri i nxënësve të larguar nga shkolla	12
Numri i nxënësve të shkollës të regjistruar në fillim të vitit shkollor	607
Përqindja	2%

Përqindja rrumbullakoset me numër të plotë.

Numri 2% tregon vlerën e treguesit "Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor" për shkollën.

Shënim: Nxënësit e larguar janë ata të cilët nuk vijojnë më mësimet në ndonjë shkollë tjetër, (nuk përfshihen nxënësit e transferuar, janë nxënës braktisës).

2. Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit kundrejt të gjitha orëve mësimore të një viti mësimor.

Numri i orëve mësimore të një viti shkollor gjendet me këtë mënyrë:

- Gjeni numrin e orëve mësimore javore të çdo klase, p.sh. të klasës së tetë, dhe shumëzoni me numrin përkatës të javëve të vitit mësimor të asaj klase.
- Numrin e orëve mësimore të një viti mësimor për një klasë shumëzoni me numrin e paraleleve që ajo klasë ka në shkollën tuaj. P.sh. kur klasa e tete ka dy paralele, 8a dhe 8b, do të shumëzoni me 2.
- Shuma e dalë më sipër shumëzohet me numrin e nxënësve në të gjithë paralelin.
- Mblidhni orët mësimore të të gjitha paraleleve të të gjitha klasave të shkollës. Shuma është "Numri gjithsej i orëve mësimore të një viti mësimor".

Numri i orëve të munguara nga nxënësit	
Numri gjithsej i orëve mësimore të një viti mësimor	
Përqindja	

3. Përqindja e nxënësve kalues në provimet e lirimt/maturës shtetërore.

Përqindja e nxënësve kalues në lëndën...	
-------------------------------------------------	--

Lëndët për të cilat do renditen shkollat për atë vit, përzgjidhen nga MAS-i ose njësia arsimore vendore.

4. Nota mesatare e shkollës në provimet e lirimt/maturës shtetërore.

Nota mesatare për lëndën...	
------------------------------------	--

Lëndët për të cilat do renditen shkollat për atë vit, përzgjidhen nga MAS-i ose njësia arsimore vendore.

Diferenca (në vlerë absolute) ndërmjet notës mesatare të shkollës në provimet e gjuhës shqipe dhe matematikës me notën mesatare të këtyre lëndëve në klasën e 9-të.

Diferenca (në vlerë absolute) ndërmjet notës mesatare të shkollës në provimet e lëndëve matematikë dhe gjuhë shqipe-letërsi me notën mesatare të këtyre lëndëve në klasën e 12-të.

MAS-i ose njësia arsimore vendore vendos nëse kjo diferencë do vlerësohet edhe për ndonjë nga lëndët me zgjedhje.

5. Përqindja e nxënësve që e kanë diferencën (në vlerë absolute) më të madhe se 1 notë (Shihni treguesit 5 ose 6).

Notat mesatare rrumbullakosen me një shifër pas presjes dhjetore.

Shembull:

Shkolla 9-vjeçare/e mesme ...

Lënda	Nota mesatare vjetore	Nota mesatare e provimit	Diferenca	% e nx >1
Matematikë	7,2	6,8	0,3	5%
Gjuhë shqipe				

6. Përqindja e nxënësve kalues në testin me një nga klasat I-III.

Sipas Dispozitave Normative, neni 15: "Drejtoria e shkollës: b) teston, të paktën tri herë gjatë vitit mësimor, ecurinë e nxënësve të klasave I-III në lëndët: gjuhë shqipe dhe matematikë.

Njësia arsimore vendore kryen teste të tillë një herë në vit.

Me qëllim që të informohet në përgjithësi për gjendjen e këtyre klasave, në zbatim të nenit 15, njësia arsimore vendore nuk është e detyruar të testojë të gjitha shkollat, por mjafton vetëm disa prej tyre.

Kur një njësi arsimore vendore vendos ta përfshijë këtë tregues në Kartën e Performancës, duhet të zhvillojë testin me të gjitha shkollat ose vetëm me ato shkolla të cilat i përkasin njërës nga grupimet që njësia arsimore vendore mund të ketë ndarë shkollat e arsimit bazë. Klasa (e parë e dytë ose e tretë), që do të caktohet për testim, përzgjidhet me short nga njësia arsimore vendore.

Në çdo shkollë testohen të gjitha paralelet e klasës së përzgjedhur.

Testi është i njëjtë për të gjitha shkollat.

Provimi zhvillohet në të gjitha shkollat në të njëjtën datë dhe orë.

7. Rezultatet e nxënësve në testin me një nga klasat I-III.

Vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve do të bëhet sipas 5 shkallëve, meqenëse në klasat I-III përdoret vlerësimi me shprehje.

Rezultati	1	2	3	4	5	Gjithsej
Numri i nxënësve	3	15	7	3	1	29

Gjetja e vlerës së treguesit

	1	2	3	4	5	Gjithsej
Nr. i nxënësve	3	15	7	3	1	29
Përqindja	10%	52%	24%	10%	3%	100%
Pikët	4	3	2	1	0	
Shumëzimet	0.41	1.55	0.5	0.1	0	2.55

Numri 255 tregon vlerën e treguesit. (Del nga shumëzimi i 2.55 me 100.)

8. Përqindja e nxënësve kalues në testin me një nga klasat e tjera, përveç klasave I-III.

Sipas DN, neni 18: "Nga fundi i vitit mësimor, drejtoria e shkollës organizon provimet vjetore me short për të gjitha lëndët ose fushat e të nxënësve dhe të gjitha klasat, me përjashtim të klasës së nëntë dhe të klasës së fundit të arsimit të mesëm të lartë."

Në këtë short përfshihen të gjitha lëndët e klasës së arsimit bazë dhe lëndët bërthamë e ato me zgjedhje të detyruar të gjimnazit, përfshirë edhe lëndët e arteve dhe lëndën e edukimit fizik dhe sporteve.

Shorti për klasën që do të testohet dhe procedurat e zhvillimit të testit janë të njëjta me provimin në klasat I-III.

9. Nota mesatare e nxënësve në testin me një nga klasat tjera përveç klasave I-III.

10. Diferenca (në vlerë absolute) ndërmjet notës mesatare të nxënësve dhe të testit të përshkruar tek treguesi 10.

11. Përqindja e nxënësve që e kanë diferencën (në vlerë absolute) e përshkruar te treguesi 12, më të madhe se 1 notë.

12. Numri mesatar i krediteve të fituara nga punonjësit arsimorë të shkollës (drejtor, nëndrejtor, mësues) gjatë vitit shkollor.

Llogariten si kredite vetëm ato kredite të dëshmuara me certifikata të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nëpërmjet Komisionit të Akreditimit të Trajnimeve.

Mblidhen kreditet e fituara nga drejtuesit (drejtori, nëndrejtorët) dhe mësuesit gjatë vitit shkollor. Kjo shumë pjesëtohet me numrin e punonjësve arsimorë të shkollës me kohë të plotë dhe që nuk janë mësues ndihmës. Numri mesatar i krediteve rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore.

13. Realizimi i objektivit (objektivave) të planit vjetor të shkollës.

Objektivat	Gjendja	Plani	Realizimi
Përqindja e nxënësve që largohen nga shkolla të jetë 1.7%.	3.1%	1.7%	2.0%
Numri i mungesave vjetore për nxënës të jetë 8.	9	8	6

“Gjendja” do të thotë sa ka qenë vlera e objektivit një vit shkollor para se të vendoset ky objektivi. P.sh., shkolla e ka pasur përqindjen e nxënësve të larguar nga shkolla 3,1% (Kjo është gjendja.) , e ka planifikuar 1.7% (plani) dhe ka arritur në fund të vitit mësimor 2.0% (realizimi).

Njësitë arsimore vendore kanë jo vetëm detyrën që të firmosin planet vjetore të shkollave, por edhe përgjegjësinë të verifikojnë përmbushjen e objektivit/objektivave të planeve vjetore. Kjo përgjegjësi merr rëndësi të veçantë tani që ky tregues përfshihet në Kartën Performancës.

✓ **Gjetja e vlerës së treguesit**

Plotësoni një tabelë si më poshtë, duke pasur parasysh se çdo objektivi i realizuar ose përtej realizimit merr (+1) pikë, kurse objektivi i përealizuar merr (-1) pikë.

Objektivi	Plani	Arritja	Realizimi	Pikët
Përqindja e nxënësve që largohen nga shkolla.	1.7%	2.0%	Jo	- 1
Numri i mungesave për nxënës.	8	6	Po	+ 1
Pikët totale				0

Pikët totale tregojnë vlerën e këtij treguesi.

14. Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin që shpall MAS-i.

Fitues janë mësues, nxënës ose shkolla që kanë certifikatën nga MAS-i. Nëse nuk është shpallur konkurrim, shkruani “Nuk është shpallur”.

Vendi që zë shkolla	Numri i fituesve
I	0
II	2
III	0
IV	0
V	1
VI	0
VII	0
VIII	0
IX	4
X	2
Ka marrë pjesë, por nuk ka zënë një nga 10 vendet e para (nuk llogaritet përqindja).	3

✓ Gjetja e vlerës së treguesit

Në tabelën më poshtë, te shtylla “Rezultati i shumëzimeve”, rezultatet gjenden duke shumëzuar për çdo rresht: Pikët x Numri i fituesve x Përqindja kundrejt të gjithë fituesve. Shuma e rezultateve të shumëzimeve rrumbullakoset në numër të plotë.

Vendi që zë shkolla	Pikët	Nr. i fituesve	Përqindja kundrejt të gjithë fituesve	Rezultati i shumëzimeve
I	11	0	0%	0
II	10	2	22%	4.4
III	9	0	0%	0
IV	8	0	0%	0
V	7	1	11%	0.7
VI	6	0	0%	0
VII	5	0	0%	0
VIII	4	0	0%	0
IX	3	4	44%	5.28
X	2	2	22%	0.88
Ka marrë pjesë, por nuk ka zënë një nga vendet e mësipërme.	1			
Shuma		9		11.33

Numri 11 është vlera e këtij treguesi për këtë shkollë.

15. Numri i çmimeve fituese të shkollës në konkurrimin që shpall njësi arsimore vendore.

Fitues janë mësues, nxënës ose shkolla që kanë certifikatën nga njësi arsimore vendore. Nëse nuk është shpallur konkurrim, shkruani “Nuk është shpallur”.

Numri i vendeve fituese caktohet nga njësi arsimore vendore, por nuk është më i madh se pesë.

Vendi	Vendi i parë	Vendi i dytë	Vendi i tretë	Vendi i katërt	Vendi i pestë
Numri i fituesve					

✓ Gjetja e vlerës së treguesit

Vlera e treguesit gjendet me këtë mënyrë:

- a) Shumëzoni “Numri i fituesve” me “Pikët” përkatëse dhe rezultatin vendoseni te kutiza përkatëse te rreshti “Shumëzimet”.

b) Mblidhni të gjitha rezultatet e shumëzimeve dhe vendosni shumën te kutiza “Gjithsej”.

Vendi	Vendi i parë	Vendi i dytë	Vendi i tretë	Vendi i katërt	Vendi i pestë	Gjithsej
Pikët	5	4	3	2	1	
Numri i fituesve	0	1	2	0	2	
Shumëzimet	0	4	6	0	2	12

Numri 12 është vlera e këtij treguesi për këtë shkollë.

16. Përqindja e pjesëmarrjes së punonjësve arsimorë (drejtues dhe mësues) në rrjetet profesionale.

Nëse njësia arsimore vendore nuk ka organizuar rrjetet profesionale, shkruani “Nuk ka rrjet profesional”.

Takimet e rrjeteve profesionale	Nr. i punonjësve arsimorë që kanë marrë pjesë
Takimi 1 i mësuesve të matematikës së arsimit të mesëm të ulët	5
Takimi 2 i mësuesve të matematikës të arsimit të mesëm të ulët	6
Takimi 1 i drejtuesve të shkollës	2
Takimi 1 i mësuesve të fillores	9
Takimi 2 i mësuesve të fillores	8
Takimi 3 i mësuesve të fillores	7
...	

✓ Gjetja e vlerës së treguesit

Njësia arsimore vendore ka të dhënat për pjesëmarrjen dhe mungesat e punonjësve arsimorë të një shkolle në rrjetet profesionale të organizuara nga njësia arsimore vendore. Këto të dhëna duhet t’ia dërgojë çdo shkolle.

- Gjendet numri i punonjësve arsimorë të shkollës që kanë marrë pjesë në secilin takim të rrjetit profesional.
- Për secilin takim të rrjetit profesional gjendet numri i punonjësve arsimorë të shkollës që duhej të merrnin pjesë.
- Mblidhen numrat e pikës a).
- Mblidhen numrat e pikës b).
- Gjendet përqindja e numrit në pikën c) kundrejt numrit në pikën d).

Quhen mungesa të punonjësve arsimorë në rrjetet profesionale edhe mungesat për shkaqe të arsyeshme si sëmundje, etj.(anëtarë të rrjeteve profesionale janë të gjithë mësuesit e një lënde të të gjitha shkollave të njësisë arsimore vendore. Mësuesit mund të grupohen sipas

cikleve në të cilat japin mësim. Në rrjete përfshihen mësuesit me kontratë pune të përhershme).

Takimet e rrjeteve profesionale	a) Nr. i punonjësve arsimorë të shkollës që kanë marrë pjesë	b) Nr. i punonjësve arsimorë të shkollës që duhej të merrnin pjesë
Takimi 1 i mësuesve të matematikës së arsimit të mesëm të ulët	5	6
Takimi 2 i mësuesve të matematikës të arsimit të mesëm të ulët	6	6
Takimi 1 i drejtuesve të shkollës	2	2
Takimi 1 i mësuesve të fillores	9	9
Takimi 2 i mësuesve të fillores	8	9
Takimi 3 i mësuesve të fillores	7	9
Shuma	c) 37	d) 41
Përqindja	90%	

Numri 90% tregon vlerën e treguesit.

17. Rezultatet e mësuesve të shkollës në provimet e kualifikimit gjatë pesë viteve të fundit shkollore.

Rezultati	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët	Gjithsej
Numri i mësuesve	3	15	7	3	1	29

✓ Gjetja e vlerës së treguesit

	Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët	Gjithsej
Nr. i mësuesve	3	15	7	3	1	29
Përqindja	10%	52%	24%	10%	3%	100%
Pikët	4	3	2	1	0	
Shumëzimet	0.41	1.55	0.5	0.1	0	2.55

Numri 255 tregon vlerën e treguesit (del nga shumëzimi i 2.55 me 100).

Drejtori i çdo shkolle duhet t'i ketë të dhënat për kualifikimin e mësuesve të tyre.

Njësia arsimore vendore duhet ta njoftojë zyrtarisht drejtorin e shkollës për këto të dhëna.

18. Përqindja e nxënësve fitues në tri preferencat e para në konkurrimin për shkollat tona të larta.

Preferencat	I	II	III	Të tjera	Gjithsej
Numri i maturantëve					

✓ Gjetja e vlerës së treguesit

Preferencat	I	II	III	Të tjera	Shuma
Pikët	3	2	1	0	
Numri i maturantëve	41	45	37	62	185
Përqindja	22%	24%	20%	34%	100%
Shumëzimet	1.33	1.46	1.20	2.01	6.00

Numri 600 është vlera e këtij treguesi.

21. Numri i projekteve që shkolla fiton në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

Vendi që zë shkolla	Vendi i parë	Vendi i dytë	Vendi i tretë	Vendi ...
Pikët e fituara	30 pikë	25 pikë	20 pikë	...

Kur një shkollë ka më shumë se një projekt të fituar, mbliidhen pikët.

SHËNIME

- Të dhënat e treguesve janë për vitin shkollor të përfunduar.
- Të dhënat e treguesve, që i takon t'i llogarisë shkolla, llogariten nga drejtori ose një nëndrejtor i saj.
- Përqindjet rrumbullakosen në numrin e plotë më të afërt.
- Notat mesatare rrumbullakosen me një shifër pas presjes dhjetore.
- Numrat dhjetorë shkruhen jo me presje, por me pikë. P.sh. 7.3.(me qëllim që të përdoret excel-i në llogaritjet).

D. PYETËSORËT

I. Të përgjithshme

Janë gjithsej tre pyetësorë: Me nxënës, me prindër të tyre dhe mësues. Qëllimi i këtyre pyetësorëve është që pjesëmarrësit të rrëfejnë mendimin e tyre për ecurinë e shkollës për fushat: **Klima dhe Etika, Kujdesi ndaj Nxënësit, Menaxhimi i Shkollës dhe treguesit** përkatës të tyre si:

- Përkujdesja për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve;
- Kushtet ekologjike, të higjienës dhe pastërtisë në mjediset e shkollës;
- Përkujdesja për mjedisin psiko-social që synon edukimin kundër dhunës (fizike, psikologjike) dhe sjelljeve të rrezikshme;

- Përkujdesja ndaj nxënësve me vështirësi në të nxënë ose me nevoja të veçanta;
- Shkalla e kënaqësisë së nxënësve, mësuesve, prindërve nga puna e shkollës;
- Funksionimi i organizmave të shkollës, etj.

Pyetësorët hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA). Për çdo pyetje të pyetësorëve tregohet mënyra e gjetjes së vlerës së saj, në mënyrë që të përfshihet në renditjen e shkollave.

IZHA u dërgon pyetësorët njësisë arsimore vendore brenda muajit mars. Njësia arsimore vendore ka të drejtë të shtojë te secili pyetësor një ose më shumë pyetje të tjera, sipas përparësive të saj.

Para zhvillimit të pyetësorëve, çdo shkollë i dërgon njësisë arsimore vendore numrin e nxënësve të çdo paraleleje të klasave 5-8 të arsimit bazë ose 10 e 11 të gjimnazit.

Në çdo vit shkollor, njësia arsimore vendore përzgjedh me short klasën në arsimin bazë dhe në gjimnaz me të cilën do të kryhet pyetësori me nxënësit. Do të marrin pjesë në pyetësor nxënësit e të gjitha paraleleve të klasës së përzgjedhur me short.

Njësia arsimore vendore përgatit fletët për të tre pyetësorët.

Zhvillimi i pyetësorëve organizohet nga njësia arsimore vendore. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët përpunohen prej saj. Titullari i njësisë arsimore vendore cakton, me një urdhër të posaçëm zyrtar, specialistët e saj dhe mësuesit të cilët marrin pjesë në realizimin e pyetësorit dhe përpunimin e të dhënave të tij.

Çdo pyetësor zhvillohet në të njëjtën ditë dhe orë në të gjitha shkollat.

Nuk duhet të jenë të pranishëm në klasat/sallën ku zhvillohet pyetësorët drejtori, nëndrejtorët dhe mësuesit e shkollës.

Aty ku është e mundur, fletët e pyetësorëve mund të plotësohen elektronikisht nga pjesëmarrësit në pyetësor.

Drejtori i shkollës ka përgjegjësinë për të siguruar numrin e duhur të pjesëmarrësve në të tre pyetësorët, si dhe mjediset e përshtatshme.

Administratorët e pyetësorëve kanë përgjegjësinë e zhvillimit korrekt të tyre.

Administratori i porosit pjesëmarrësit në pyetësor që kur ta përfundojnë së plotësuari, ta kthejnë mbrapsht fletën e pyetësorit. Administratori nuk duhet t'i ngutë pjesëmarrësit.

Ka rëndësi që administratori t'u shpjegojë me pak fjalë pjesëmarrësve në pyetësor pse pyetësori është i dobishëm për ta. Nxënësve dhe prindërve mund t'u thuhet se mendimet e tyre do të vlejnjë që shkolla të bëhet edhe më e mirë për ta. Mësuesve mund t'u thuhet se mendimet e tyre do t'i vlejnjë njësisë arsimore vendore dhe Ministrisë që t'i ndihmojnë më shumë në punën e tyre.

Kur numri i specialistëve të njësisë arsimore vendore është i pamjaftueshëm që të zhvillohen pyetësorët, titullari i njësisë arsimore vendore cakton mësues të luajnë rolin e administratorit. Mësuesi duhet të administrojë një shkollë së cilës nuk i përket. Më mirë do të jetë që mësuesit e shkollave të arsimit bazë dhe atyre të gjimnazit të këmbëhen.

Mbi fletën që mbështjell pyetësorët, shkruhet emri i shkollës.

II. Pyetësori me nxënësit

Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, anëtarët e grupit të pyetësorit në një shkollë shpërndahen në paralelet e klasës së përzgjedhur për pyetësorin (në një klasë-një anëtar i grupit). Pyetësori zhvillohet sipas një shorti.

Për të marrë përgjigjet e vërteta të nxënësve, ka shumë rëndësi takti me ta.

Administratori i pyetësorit duhet të jetë jo i ngrysur dhe as me qëndrim të ftohtë zyrtar. Ai u shpjegon me dashamirësi nxënësve, se, ashtu si në shkolla të tjera, edhe në këtë shkollë do të kryhet një pyetësor me nxënësit. Ai thotë pak a shumë: "Te ky pyetësor ka disa pyetje. Secili do të japë përgjigjen e vet, ashtu si e mendon. Emrin nuk do ta shënoni".

Pasi u ka shpërndarë pyetësorët, i sqaron thjesht dhe shkurt se si do ta plotësojnë.

Administratori lexon njëri nga pyetjet, pastaj i porosit që të vendosin vetëm një shenjë "X" në kutizën nën përgjigjen që ata zgjedhin.

Administratori duhet të sigurohet se nxënësit i kuptuan sqarimet e tij.

III. Pyetësori me prindërit

Në pyetësor duhet të marrin pjesë të paktën 10% e prindërve të nxënësve të shkollës. Pyetësori zhvillohet në takimin e fundit me prindër.

Kur nuk sigurohet ky prag minimal, pyetësori nuk zhvillohet ose nuk ka vlerë. Në këtë rast, për pyetjet për prindërit, shkolla, që nuk ka arritur të sigurojë numrin e mjaftueshëm të prindërve, zë vendin e fundit në renditje për të gjitha pyetjet e këtij pyetësori.

IV. Pyetësori me mësuesit

Në pyetësor duhet të marrin pjesë të gjithë mësuesit e shkollës që nuk mungojnë ditën e realizimit të pyetësorit dhe vetëm të turnit të paradites. Në pyetësor nuk marrin pjesë mësuesit me kohë të pjesshme dhe ata ndihmës. Pyetësori zhvillohet në një klasë të shkollës.

E. SI TË GJENI VLERAT E TREGUESVE NË EXCEL?

Duke përdorur excelin mund të gjenden shpejt dhe lehtë vlerat e të gjithë treguesve, përfshirë dhe të pyetjeve të pyetësorëve.

Në faqen e internetit, që përmban këtë Udhëzues, ju do të gjeni një faqe në excel ku mund të kryeni llogaritjet.

I. Gjetja e përqindjes

Janë tre kutiza. Vendoni numrin total të kutiza e parë. Numri total, sipas rastit, është: Numri i nxënësve që kanë hyrë në provimet e lirimit, numri gjithsej i orëve mësimore të një viti mësimor, numri i prindërve që kanë marrë pjesë në pyetësor.

Vendosni në kutizën e dytë numrin që kërkoni t'i gjeni përqindjen si: Numri i nxënësve kalues në provimet e lirimi, numri i orëve të munguara nga nxënësit, numri i prindërve që janë përgjigjur "Po".

Menjëherë te kutiza e tretë del përqindja që kërkoni.

Bashkëlidhur me Udhëzuesin e Kartës, formula në excel.

II. Gjetja e vlerës së treguesit me katër alternativa

Në reshtin e parë janë pesë kutiza. Vendosni me radhë te kutizat numrat e pjesëmarrësve. Vendosni te kutizat e rreshtit të parë numrat e pjesëmarrësve, që kanë dalë nga pyetësi, dhe i korrespondojnë me radhë 3 pikëve, 2, 1 dhe 0 pikëve. Në kutizën e pestë del menjëherë shuma e pjesëmarrësve. Rreshti i tretë dhe i katërt plotësohen automatikisht. Menjëherë del vlera e treguesit që kërkoni.

F. RENDITJA E SHKOLLAVE NGA NJËSIA ARSIMORE VENDORE

I. Renditja e shkollave për një tregues

- Në vend të parë vendoset shkolla që ka vlerën më të mirë të treguesit e pastaj kështu me radhë.
- Kur dy shkolla kanë të njëjtën vlerë të një treguesi, zënë të njëjtin vend në renditje.
- Në treguesit përfshihen dhe të dhënat statistikore të përpunimit të pyetësorëve.

Shembuj

Treguesi

Shkollat	%	Renditja/Vendi
Shkolla A	1%	2
Shkolla B	1%	2
Shkolla C	0%	1
Shkolla D	4%	3
Shkolla E	5%	4

Treguesi

Shkollat	Vlerat	Renditja/Vendi
Shkolla A	79	2
Shkolla B	65	4
Shkolla C	11	5
Shkolla D	81	1
Shkolla E	66	3

II. Renditja e shkollave për të gjithë treguesit

- Në një tabelë, për secilin tregues vendoset vendi që zë çdo shkollë bashkë me vlerën e treguesit.
- Për secilën shkollë mblidhen numrat e vendeve që ka zënë për të gjithë treguesit.
- Renditen shkollat për të gjithë treguesit.
Shkolla me shumën më të vogël të pikëve zë vendin e parë e pastaj kështu me radhë.
Kur dy shkolla kanë shumë të njëjtë të pikëve, zënë të njëjtin vend.

Shembull (në këtë shembull, për thjeshtësi paraqitjeje, janë marrë pak shkolla dhe tregues).

Treguesit	Shk. A	Shk. B	Shk. C	Shk. D	Shk. E
Përqindja e nxënësve. të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor.	2	2	1	3	4
Rezultatet e mësuesve në provimet e	3	4	1	2	4

kualifikimit në pesë vitet e fundit.					
Përqindja e pjesëmarrjes së punonjësve arsimorë (drejtues dhe mësues) në rrjetet profesionale.	1	4	3	2	4
Përpunimi i pyetësorëve për treguesin...(emërtimi i treguesit)	1	2	5	4	3
Përpunimi i pyetësorëve për treguesin... (emërtimi i treguesit)	2	2	4	1	3
Shuma e vendeve	9	14	14	12	18
RENDITJA E SHKOLLAVE	1	3	3	2	4

III.Renditja e shkollave për ndryshimet ndërmjet dy viteve shkollore

Në vitin pasues shkollor, Karta përmban edhe vendin që zë shkolla në mes shkollave të tjera për ndryshimet ndërmjet dy viteve shkollore të njëpasnjëshme, d.m.th. ndërmjet vitit të kaluar shkollor dhe vitit shkollor paraardhës me të. Këto ndryshime njehsohen vetëm për treguesit që i takojnë dy viteve të njëpasnjëshme. Me këtë mënyrë nuk dalin në krye përherë pak shkolla të shquara, por edhe ato shkolla që nuk janë dalluar për rezultate të larta, por kanë ndryshime pozitive të spikatura nga viti në vit.

Shembull

Treguesi “Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor”

Treguesi	Shk. A	Shk. B	Shk. C	Shk. D	Shk. E
Viti shkollor paraardhës	1%	1%	0%	4%	5%
Viti i kaluar shkollor	1%	2%	2%	3%	2%
Diferenca	0%	-1%	-2%	1%	3%
Renditja e shkollave	3	4	5	2	1

Shënim: Renditja për dy vitet e njëpasnjëshme shkollore fillon për vitet shkollore 2014-2015 dhe 2015-2016.

IV.Renditja tërësore e shkollave

Renditja tërësore e shkollave përfshin renditjen për vitin e kaluar shkollor dhe renditjen për ndryshimet në dy vitet e njëpasnjëshme.

Shembull

Treguesi “Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla kundrejt nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor”

Treguesi	Shk. A	Shk. B	Shk. C	Shk. D	Shk. E
Renditja në vitin e kaluar shkollor	1	3	3	2	4
Renditja për ndryshimet në mes dy viteve të njëpasnjëshme	3	4	5	2	1
Shuma e vendeve	4	7	8	4	5
Renditja tërësore e shkollave	1	3	1	2	2

V. Shpallja e renditjes së shkollave sipas treguesve

Sipas Dispozitave Normative, Kreu XXIV, neni 126/3: “Drejtoria e çdo shkolle vendos në një vend të dukshëm për nxënësit dhe prindërit tabelën e renditjes së shkollës për çdo tregues dhe për treguesit në tërësi”.

Njësia arsimore vendore e vendos tabelën e përgjithshme të renditjes së shkollave për çdo tregues dhe për treguesit në tërësi në një vend të dukshëm për nxënësit dhe prindërit, gjithashtu e publikon në faqen e saj të internetit.

Sipas nenit 126/4 të Dispozitave Normative, njësia arsimore vendore shpall shkollat e suksesshme me një ceremoni të posaçme. Njësia arsimore vendore paracakton numrin e shkollave më të mira. P.sh. ato që zënë tri ose pesë vendet e para.

Procedurat e hartimit të Kartës janë objekt i inspektimit nga ISHA.

G. DETYRA TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË HARTIMIN E KARTËS

I. Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Arsimit dhe Sportit:

- Organizon hartimin e treguesve dhe të pyetësorëve.
- Përshkruan mënyrën e gjetjes së vlerës së tyre për pyetësorët dhe treguesit e rinj.
- Harton listën vjetore të treguesve dhe e shpall në Udhëzimin e Vitit të Ri Shkollor.
- Bazuar në raportet e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit kryen përmirësimet e nevojshme të Kartës.
- Përditëson këtë Udhëzues.

Te revista “Mësuesi” botohen emrat e shkollave të suksesshme në nivel njësie arsimore vendore, bazuar te Karta.

II. Njësia arsimore vendore

Titullari i njësisë arsimore vendore ka përgjegjësi për saktësinë e renditjes së shkollave.

Njësi arsimore vendore ka këto detyra:

- Ndan në grupe shkollat e arsimit bazë nëse e gjykon të nevojshme.
- Informon shkollat për treguesit vjetorë qendrorë të shpallur nga MAS-i.

- Përzgjedh treguesit që do të përdorë në nivelin rajonal për renditje përveç treguesve qendrorë (Këta mund të përzgjidhen nga Udhëzuesi ose mund të hartohen nga vetë njësia arsimore vendore).
- Organizon një mbledhje me drejtorët dhe nëndrejtorë të shkollave, ku i sqaron për detyrat e tyre në plotësimin e Kartës.
- Cakton me short klasën ku do të zhvillohen pyetësorët me nxënësit e arsimit bazë dhe të gjimnazit.
- Verifikon disa nga të dhënat për Kartën të dërguara nga shkollat, në veçanti realizimin e objektivit/objektivave të planit vjetor.
- Merr masa për drejtorëve të shkollave që kanë shkelur Udhëzimet e Ministrit kur është fjala për falsifikimin e dokumenteve zyrtare që shkolla harton ose për pasaktësi të përsëritura.
- Shton pyetje te pyetësorët e dërguara nga MAS-i.
- Zhvillon pyetësorët.
- Përpunon të dhënat e disa treguesve dhe të pyetësorëve, siç përshkruhen në këtë Udhëzim.
- Rendit shkollat.
- Publikon në faqen e saj zyrtare të internetit kartat e të gjitha shkollave.
- Shpall shkollat e suksesshme.
- Organizon ceremoninë për shkollat e suksesshme.
- Titullari i njësisë arsimore vendore cakton koordinatorin, i cili organizon plotësimin e Kartës nga shkollat dhe përpunimin e të dhënave në njësinë arsimore vendore.

III. Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës dërgon me shkrim te titullari i njësisë arsimore vendore të dhënat për të gjithë treguesit e parashikuar në këtë Udhëzues (përveç rasteve kur kjo nuk është e mundur të llogaritet si p. sh: mos marrja pjesë në konkurrimet e ndryshme, rrjetet profesionale nëse nuk janë organizuar nga njësia arsimore vendore), duke shënuar datën e dërgimit, firmën e tij dhe vulën e shkollës.

Drejtori i shkollës mban përgjegjësi për saktësinë e çdo të dhëne që i dërgon njësisë arsimore vendore.

Drejtori duhet të ketë vetë parasysh dhe duhet t'ia bëjë të qartë nëndrejtorit, që mund të merret me përpunimin e të dhënave të treguesve, po ashtu edhe mësuesve, që japin të dhëna, se, sipas udhëzimeve Nr. 56, Nr. 57, Nr. 58, datë 12.11.2013 të ministrit të Arsimit dhe Sportit, titullari i njësisë arsimore vendore shkarkon drejtorin e shkollës dhe drejtori i shkollës shkarkon nëndrejtorin, gjithashtu, largon nga puna mësuesin, kur përkatësisht drejtori, nëndrejtori i shkollës, mësuesi:

- ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- ka nxitur vartësit të falsifikojnë dokumente zyrtare.

Drejtori i shkollës, nëndrejtori dhe mësuesit duhet të dinë se të dhënat e treguesve do të verifikohen nga njësia arsimore vendore.

J. AFATET

- Njësitë arsimore vendore zhvillojnë pyetësorët gjatë periudhës prill-maj dhe përpunojnë të dhënat e tyre brenda muajit maj.
- Drejtori i shkollës dorëzon te njësia arsimore vendore deri më 20 korrik të dhënat për të gjithë treguesit që janë parashikuar të njehsohen nga vetë shkollat.
- Njësi arsimore vendore verifikon deri më 10 shtator saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të dërguara nga shkollat. Verifikimi bëhet jo për të gjitha shkollat, por jo më pak se 10% të shkollave në juridiksion, dhe në shkollën, që përzgjidhet për verifikime, shqyrtohet një pjesë e treguesve. Ato shkolla, tek të cilat janë verifikuar pasaktësi të të dhënave për tregues të caktuar, renditen për ata tregues në fund të renditjes.
- Njësia arsimore vendore qarkullon një letër informuese me të cilën njofton të gjitha shkollat në juridiksion për pasaktësitë e konstatuara duke përmendur edhe shkollat ku janë vërejtur pasaktësitë.
- Shkollat përgatisin Kartën e tyre të Performancës brenda datës 20 shtator të çdo viti.
- Në fund të shtatorit, njësia arsimore vendore shpall renditjen e shkollave sipas treguesve në një ceremoni të veçantë.

H. PËRMBAJTJA E KARTËS SË PERFORMANCËS (një shembull)

KARTA E SHKOLLËS

Shkolla "Demokracia"

Adresa elektronike: demokracia.1988@yahoo.com

Numri i nxënësve të shkollës të regjistruar në fillim të vitit shkollor: 852

Synimi i planit vjetor: Përmirësimi i arritjeve të nxënësve në provimet e lirimit.

Objektivat e planit vjetor: Mesatarja e e nxënësve në provimin e lirimit të gjuhës shqipe e letërsisë të jetë 7,1 dhe të matematikës 6,9.

Përqindja e kalueshmërisë dhe nota mesatare e shkollës në vitin e kaluar shkollor: 98%, 6,8

Në vitin shkollor 2010-2011 Inspektorati Shtetëror i Arsimit e ka vlerësuar "Mirë"

Në vitin shkollor 2012-2013 ka fituar vendin e tretë në nivel rajonal.

VENDI QË ZË SHKOLLA NË KRAHASIM ME 12 SHKOLLA TË TJERA

Treguesit/Renditja e shkollave	Viti i kaluar	Ndryshimi nga një vit më parë	Gjithsej
Përqindja e orëve të munguara nga nxënësit	6 (3%)	2 (-2%)	5
Nota mesatare e nxënësve në provimet e lirimit	3 (7.3)	4 (+0.5)	3
Përqindja e nxënësve të larguar nga shkolla	2 (1%)	7 (1%)	4
Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin që shpall MAS-i	12	6	10
Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin që shpall	9	3	5

Rezultatet e mësuesve të shkolles ne provimet e kualifikimit gjatë tri viteve të fundit shkollore	4	2	2
Përpunimi i pyetësorëve për treguesin... (emërtimi i treguesit)	4	3	3
Përpunimi i pyetësorëve për treguesin... (emërtimi i treguesit)	4	2	3
Vendi i shkollës në renditjen tërësore.			4

Shkolla mund ta paraqesë këtë Kartë me pamje sipas ideve të saj krijuese.

Për disa tregues vendoset në Kartë jo vetëm vendi që ka zënë shkolla, por edhe vlera e treguesit. Tregues të tillë janë, në përgjithësi, ata me përqindje dhe notë mesatare.